



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:144428

Datë: 06.12.2023

Numri i dokumentit: 05019370

P.nr.593/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi – Imami, në çështjen penale kundër të pandehurit G.G. nga P, rr.” ” nr. ..., i akuzuar për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.941/22, të datës 15.07.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 30.11.2023, në praninë e prokurorit të shtetit Sadije Muriqi, të pandehurit G.G, mbrojtësit të tij av. Sh. M, në të njëjtën ditë, bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 06.12.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

G. (Xh.) G, i lindur me datë ... në P., ku edhe banon në rr.”...” nr..., i lindur nga babai Xh. G, dhe nëna V. G, ka të përfunduar shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike ,beqar, i identifikuar në bazë të numrit personal

....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Me datë 30.03.2022, rreth orës 20:30 min, në P., në oborrin e shkollës së mesme të ulët “...”, pa autorizim posedon narkotikë , në atë mënyrë që pasi patrulla policore në planin operativ” siguria –stop drogave në shkolla, në oborrin e shkollë së lartcekur vërejnë të pandehurin G. së bashku edhe me dy persona të tjerë duke qëndruar ulur, ashtu që pasi ju janë afruar, të pandehurit G. në xhepin e pantallonave i kanë gjetur një qese të mbështjelltë me folje dhe pas ekzaminimit të saj me Nar test NTX2000 ka rezultuar të jetë substancë narkotike e llojit marihuanë, me peshë neto prej 4.6 gram, ndërsa tek personi tjetër gjejnë një palë gërshërë, një shkrepëse dhe 6 fyshtëza,

-me çka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 të KPRK-së,

Gjykata konform nenit 7, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, nenit 269 par.1, të KPRK-së dhe nenit 364 të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË në shumën prej 300 (treqind) euro,

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 4 (katër)muaj i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind)euro,

Gjykata konform nenit 76 të KPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

DËNIM UNIK ME GJOBË në shumën prej 700 (shtatëqind euro) €, të cilin dënim obligohet të e paguajë brenda afatit prej 3 (tre) muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë i njëjti do të i zëvendësohet në dënim me burgim, ku një ditë burgim llogaritet 20 (njëzetë euro) €.

I pandehuri obligohet në paguarjen e shpenzimeve për paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet euro) €, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 20 (njëzet euro) €, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 269 par.3 të KPRK-së të KPPRK-së, substanca narkotike e llojit marihuanë në peshën neto 4.6 gram, konfiskohet dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, urdhërohet shkatërrimi i saj.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, me datë 15.07.2022, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.941/22, ndaj të pandehurit G.G. nga P, i akuzuar për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1, të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPPRK-së me dt. 30.11.2023, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, ku ishin prezent prokurori i shtetit S. M, i pandehuri G.G. dhe mbrojtësi i të pandehurit av. Sh. M. sipas autorizimit.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij, dhe se për mbrojtës ka të angazhuar.

Konform nenit 241 par.3, të KPPRK-së, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës PP/II.nr. 941/22 të datës 15.07.2022, nga prokurori i shtetit.

Gjykata, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë.

I pandehuri G.G. deklarojë se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndjehet i penduar dhe i premtos gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra tjera penale, duke shtuar se pranimin e fajësisë e bënë vullnetarisht pa asnjë presion.

Prokurori i shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklarojë që pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ky pranim fajësie është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që të e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par.2, të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit i datës 30.03.2022, nr. rasti ..., raporti i oficerit B. N. me nr. rasti, procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurit G.G., dhënë në stacionin policor në P., me datë 30.03.2022, nr. rasti, procesverbali i marrjes në pyetje i dëshmitarit H. K, dhënë në stacionin policor në Pejë, me datë 30.03.2022, nr. rasti, raporti i analizës narkotike i DHTN në Pejë i datës 04.04.2022, Foto dokumentacioni, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 30.03.2022, nr. rasti, si dhe shkresat e tjera bashkëngjitur lëndës, andaj gjykata konform nenit 242 par.6, të KPPRK-së mori aktvendim me të cilin e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit për veprën penale ” posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge ” nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit G.G. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale *posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit prandaj edhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshme për veprën e kryer dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka konsideruar: pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, kurse rrethana rënduese ndaj tij gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të

parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

I pandehuri pas shpalljes së aktgjykimit ka dhënë pëlqimin që dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër) muaj, të i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej 400 (katërqind euro) €.

Duke u bazuar në nenin 449 par.1 dhe 2, nënpar.2.6, të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar për paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 269 par. 1 të KPPRK-së, lidhur me nenin 269 par. 3 të KPRK-së, substancën narkotike të llojit marihuanë, në peshën neto 4.6 gram, gjykata e konfiskojë dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, është urdhëruar shkatërrimi i saj.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata e përpiloj këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 593/22, datë 06.12.2023

Bashkëpunëtore Profesionale
Kaltrina Rexhepi-Imami

GJYQTARI
Veton Ademaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.